



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 142, datë 27.04.2021

PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit **Olgert Rumnici** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe caktimin në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, shpallur me Vendimin nr.339, datë 29.12.2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim Z. **Olgert Rumnici**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.07.2021 dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI